



PROCESVERBAL II/2025

I mbajtur me rastin e mbledhjes së II (dytë) për vitin 2025 të Komitetit për
Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 20.02.2025
Ora : 13:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues

Të pranishëm tjerë:

z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Fidaije Kukaj
z. Dardan Berisha
z. Liridon Fandaj

Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend Dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurta të pronës së paluajtshme të Komunës-lokalet;
3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurta të pronës së paluajtshme të Komunës-Panot reklamuese;
4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ri-alokimin e mjeteve nga fondi burimor (38),Granti Qeveritar-Rezervat për vitin fiskal 2025 në projektin kapital;
5. Shqyrtim i projekt-vendimit për miratimin e kërkesës;
6. Shqyrtimi i raportit vjetor për kontratat e nënshkruara publike për vitin 2024;
7. Shqyrtimi i planifikimit përfundimtar i prokurimit për vitin 2025;

Kryesuesi- Përhëndet të pranishmit dhe i njofton me rendin e ditës.E hedh në votim rendin e dites:

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurta të pronës së paluajtshme të Komunës-lokalet;

Kryesuesi - e laboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka – Përhëndet të pranishmit.Unë ju kërkoj falje sepse nuk kam informacione të sakta se për cilat objekte bëhet fjalë,dhe kërkoj nga drejtori të na informojë më saktë për cilat objekte bëhet fjalë,cili është statusi i këtyre objekteve deri më tashë,a ka qenë duke i shfrytëzu dikush deri më tani, a ju ka skadu kontrata,sepse kam pak informacione për me e ditë se qka me vendosë.

Armend Krasniqi–Përhëndet të pranishmit,Këtu bëhet fjalë për dy lokale,lagjja Gradina te Kumanova,Aty i kemi nda dhe i kemi regjistru ne Kadaster dhe i kemi bë me çertifikatë të pronës dhe e kemi nisë procedurën për dhënjën në shfrytëzim,kan qenë duke u shfrytëzu lokalet mirpo kontrata ju ka skadu më shumë se 2 vite mirpo kan qenë pagues të rregullt,dhe i kemi largu,lokalet janë të lira sepse kështu po e kërkon ligji dhe e kemi inicu procedurën për dhënjën në shfrytëzim.

Liridon Fandaj- Përshëndet të pranishmit.Në material mendojë që ish dashtë me qenë edhe gjendja faktike ose të paktën disa fotografi të këtyre lokaleve ,po besojë që këto metra që janë në certifikate janë pronë publike dhe të Komunës por gjendja faktike në teren ndoshta nuk është kështu.Në material ish dashtë me qenë fotografit dhe metrat saktësisht të matura prej Drejtorisë përkatëse.Qdo pronë publike që po jepet në shfrytëzim,të paktën me pas njëfar gjendje si ka ardh deri këtu,sa janë obligimet e atyre që kanë qenë më parë.Drejtori po thot që ata janë kanë tatimpagues të rregullt,kërkesa ime është që në mbledhje të Asamblesë me pas një kartel financiare të obligimeve deri tash por edhe disa fotografi të gjendjes faktike qysh janë lokalet për momentin.

Armend Krasniqi-Faktikisht gjendja e lokaleve dhe pronave në Komunën e Suharekës para se me ardhë unë drejtor ka qenë jashtëzakonisht e keqe,mirpo disa procedura që i kemi zhvilluar dhe kemi insistur që të rregullojmë disa probleme nga shumë të cilat i ka Komuna dhe Kadastra.Disa nga problemet të cilat i kemi rregullu ka qenë regjistrimi të gjithave objekteve dhe lokaleve të cilat janë pronë e Komunës.Aty ku e kemi pa për me e bë ndarjen lokaleve ,e kemi nda,përshkak që mos me kriju monopol,këto realisht kanë qenë 1 lokal,mirpo e kemi bë ndarjen në dy lokale nga 47m²,më mirë le të jenë 2 përfitues sesa 1.Gjithsej në atë bllok kanë qenë 4 lokale,por unë kam marrë vendim si Drejtori me i bë 8 lokale në mënyrë që të përfitojnë 8 biznese të qëndrueshme,kjo ka qenë logjika ime si Drejtor.Në kuader të këtyre kemi bë regjistrime të shumë banesave,dhe janë të paisura me certifikata të pronës,sepse nuk kanë pas dhe nuk e kanë ditë kerkush psh ku është kjo,si është kjo pronë e kujt është kjo.Kemi bërë disa veprime të mira,të cilat po i dergojmë dhe në Asamble,ku mundën me përfitu qytetaret dhe me pas kontrata të rregullta midis Komunës dhe Operatorëve ekonomik.,sa i përket fotove kur të formohet Komisioni në mundemi me bë kritere, se çfarë kërkon Komuna për me e marrë atë lokal.

Liridon Fandaj-Unë nuk e kërkoja në Komision por në Asamble,me na sjell materialin edhe për gjendjen financiare edhe fotografitë për gjendjen faktike.

Armend Krasniqi-Për kartelat financiare nuk është një problem e bashkangjesim dhe i sjellim në Asamble.

Urim Suka-Unë nuk e kuptova kanë qenë 4 lokale i kemi bë 8,si ide e mirë por qka ka ndodh fizikisht nuk e kuptova,përndryshe pjesën tjetër Drejtori e sqaroi mirë dhe unë po mendojë që ne i japim mbështetje si projekt-vendim me shku tutje.Jemi pak të habitur që kjo po ndodh vazhdimisht dhe ndoshta ti nuk ke faj,sepse mundën me qenë gjëra që janë grumbullu më heret,por jemi të habitur me vonesën,sepse sipas ligjit procedurat duhet të ndiqen para se të skadojnë kontrata.

Kryesuesi- e hedh në votim pikën e 2.

Me: 6 vota Për, asnjë Kundër,1 Abstenim miratohet.

Pika 3.Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurta të pronës së paluajtshme të Komunës-Panot reklamuese;

Kryesuesi - e laboron këtë pikë dhe hap debatin.

Liridon Fandaj-Materialin që na e ka sjell Drejtori,nuk është vetëm rruga që parashihet,nuk ka saktësisht sa reklama kanë me u vendos,sa pano dhe në cilat pozicione.Duhet me i pas disa kritere:sa lejohen dhe ku lejohen të vendoset.Operatori i kalum deri në vitin 2022 ka pasë kontrat.Kush i ka inkasu mjetët dhe kush është përgjegjës për mos marrjen e maave ndaj tij.Me Drejtorin kur kam kominiku,ka thënë që unë e kam shkëput Kontraten dhe ne duhet me ditë kush është përgjegjës.Është deshtë me bë një procedurë dhe përgjegjësia me qenë e dikujt që deri tash ai ka inkasu mjete në pronë publike.Këtij projekt-vendimi dhe këtë material që e ke sjell duhet me qenë i kompletum me një kartel financiare.

Armend Krasniqi-pajtohem pjesërisht me Liridonin,është e vertet dhe është një ndër problemet më të mëdha që i kemi dy vitet e fundit dhe kanë pësuar shumë dhe Deputetet që së fundmi i kanë denu përshkak të mos Kontrates me Komunën sepse kanë vepruar në mënyrë të paligjeshme.Në momentin që i ka skaduar

Kontrata ne si Drejtori e kem njoftu Drejtorin e Inspeksionit dhe Drejtorin e Financave pershkak se ky operator ekonomik me nuk ka te drejte me vendos asnjë pano reklamuese në qytetin e Suharekës. Pas kësaj ne ekemi kry si procedurë të rregullt mirpo kjo ligjërishhtë dhe në një rregullore të cilën e kemi përgaditë,decitivisht i takon Drejtorisë së Urbanizmit,mirpo Drejtoria e Urbanizmit pershkak të joprofesionalizmit jo korrektësis dhe mos guximit për me shku më tutje dhe me lën peng Komunën,nuk ka guxu me marrë iniciativë me shty përpara si proces.Kam marrë një initiative nëse ka gabime e kthejna,nëse nuk ka na nuk mujmë me lanë këtë vend pa pano,mos me zhvillu asnjë procedur veq pse dikujtë ju ka tek,e kam pas si inciative me i ndihmu Qytetit,nëse është e gabume le ta vlerson Asambleja dhe Komuna ose kushë do tjetër.

Liridon Fandaj-Materiali që është paraqitur është i paplotësuar dhe nuk përmban asnjë kriter të qartë për vendosjen e panove.Dokumentacioni është i mangët pasi përmban vetëm një kërkes dhe disa harta rrugore të marra nga burimet online.

Urim Suka-Para nesh kemi një projekt-vendim që na është paraqitur për miratim,lidhur me lejin e panove reklamuese.Më vjen mirë që ky projekt ka ardhur në shqyrtim,pasie dimë se këto hapësira nuk janë shfrytëzuar ose,edhe më keq,janë përdorur në mënyrë të paligjshme.Problemi kryesor është se kemi pasur një vonesë të konsiderueshme prej 2-3 vitesh për një rregullim të tillë,ndërkohë që një projekt-vendim i këtij lloji duhej të ishte miratuar 2-3 muaj përpara skadimit të kontrates ekzistuese.Nga ana tjetër në raste kur një operator nuk i përmbush obligimet e përcaktuara në kontratë ,institucioni është dashtë me i ndjek procedurat ligjore.Deri më tani,kemi hasur në shumë shkelje ,të cilat kan shkaktuar dëme të mëdha.Unë jam për një projekt-vendim të qartë dhe të detajuar,sepse nuk mund ta lejojmë që të vazhdoj anarkia në këtë fushë.Siç e theksoi edhe Liridoni se kriteret për lejin e panove reklamuese duhet të jenë të jenë të specifikuara qartë,në mënyrë që të shmangët qdo paqartësi apo keqpërdorim.Dhe sugjeroi që në disa raste,për arsye specifike,mund të shqyrtohet mundësia për vendosjen e reklamave edhe në zonat rurale ,nëse kjo është e nevojshme dhe në përputhje me kriteret ligjore.

Armend Krasniqi- është e vërtetë që këto janë probleme të trashëguara dhe jashtëzakonisht të mëdha.Siç është përmendur,kartelat financiare tregojnë se operatori paraprak ka një borxh mbi 30.000€.Për më tepër,asnjë drejtor i Ekonomisë dhe Financave nuk ka ndërmarrë asnjë veprim,sado të vogël,për të trajtuar këtë çështje.Kur kam marrë detyrën si drejtor dhe kam parë borxhin prej 30.000€,është ngritur çështja se si të veprohet dhe cilat hapa duhet ndërmarrë.Kjo situat paraqet probleme të jashtëzakonshme,por nuk mund të lejojmë që ato të vazhdojnë dhe të thellohen.Unë e kam propozuar këtë si një form orientuese për të gjetur një zgjidhje së bashku.Decitivisht,kjo është një kompetencë e Drejtorisë së Urbanizmit sipas zyrtarëve ligjor dhe zyrtari ligjor që është prezent mund të japë një sqarim më të detajuar mbi këtë çështje.

Sanije Kuqi Rexhepaj-Përshendet të pranishmit,Drejtor po më vjen shumë keq që kjo çështje ka arritur në këtë nivel,ku dy drejtoritë,të cilat duhet të kenë bashkëpunim të ngushtë,po e kalojnë përgjegjësinë nga njëra te tjetra.Unë besoj se kjo është një përgjegjësi e përbashkët dhe se një kordinim më i mirë mes tyre do të rezultonte në zgjidhje më të plot dhe efikase.Pajtohem me vlerësimin e Liridonit që thot se ky projekt-vendim është dashur të hartohet më mirë.Në përmbajtjen e tij thuhet se bëhet fjalë për “vendosjen e përkohshme të tabelave dhe pano reklamuese në rrugën e zonës urbane të qytetit”,por nuk është përcaktuar qartë mënyra e shfrytëzimit,lokacionet e sakta apo mënyra e vendosjes së tyre.Po ashtu,në tekstin e projekt-vendimit nuk citohet nëse këto tabela do të vendosen në shtyllat e ndriçimit apo në ndonjë hapësirë tjetër specifike ,çka krijon paqartësi dhe vështirësi në zbatim.Për më tepër,mendoj se nuk është kompetencë e Komisionit për shpalljen e ankandit publik,pasi anëtarët e tij janë përfaqësues të Kuvendit Komunal dhe munden me qenë jo profesional në këtë çështje.Për këtë arsye,mendoj se Komuna duhet të përcaktoj kriteret të qarta teknike,duke lehtësuar kështu punën e Komisionit.Në përbërjen e Komisionit janë të përfshirë edhe përfaqësues nga shoqëria civile,të cilët,duke qenë të jashtëm,nuk munden me qenë profesional të nevojshë për këtë lloj vendimmarrje.Gjithashtu,aspektet teknike psh,dimensionet e tabelave (60x60 cm në shtyllat elektrike),është dashur të përcaktohen qartë dhe të shoqërohen me harta ,duke identifikuar lokacionet e sakta të dedikuara për vendosjen e panove.Po ashtu,mbetet e paqartë nëse ky projekt-vendim përfshin edhe “City lights”.Një tjetër çështje duhet marrë në konsideratë është se Komuna ka pasur një plan për vendosjen e objekteve të përkohshme për periudhën

2019-2024, i cili tashmë ka skaduar. Në këtë plan ishin të përcaktuara qartë zonat ku mund të vendoseshin këtë objekte. Për këtë arsye, mendoj se është e nevojshme të kemi një sqarim nga zyrtari ligjor, duke pasur parasysh se ekziston edhe një rregullore që përcakton shfrytëzimin e hapësirave publike për periudha nga 1-12 muaj, e cila është kompetencë e Drejtorisë së Urbanizmit. Megjithatë, deri më tani, për çështje të shfrytëzimit të hapësirave publike, vendimet gjithmonë kanë ardhur nga Drejtoria e Kadastrës. Kjo krijon një precedent që duhet të analizohet me kujdes për të shmangur paqartësitë institucionale në të ardhmen.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën e 3.

Me: 6 vota Për, një Kundër, 0 Abstenim, miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ri-alokimin e mjeteve nga fondi burimor (38), Granti Qeveritar-Rezervat për vitin fiskal 2025 në projektin kapital;

Kryesuesi - e laboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - Unë fillimisht po du sqarim nga ana juaj, kur kemi fol për këto rezerva gjithmonë kemi thënë se Komuna nuk ka kod për rezerva. Këto rezerva që jemi duke fol ne, a mundeni me më tregu pse përdoren, Komuna jonë pse i parasheh edhe tash nëse i marrim këto 200.000€ a bëhet 0 fondi për rezerva apo ka hala buxhet aty.

Fadil Hoxha - Përshendet të pranishmit, Fondi rezervë është i kategorizuar nën kodin 38, ndërsa të gjitha projektet kapitale janë të identifikuar me kodin 30. Nën-kodet specifike të projekteve caktohen në momentin kur ato regjistrohen në tabelën e programit të investimeve publike (PIP), ku secili projekt merr numrin dhe kodin përkatës përveç kodit 30. Në këtë rast, ky projekt nuk ka kaluar sipas kritereve të përcaktuara në Udhëzimet Administrative nr. 01 dhe 06 të vitit 2019. Pas përfundimit të punimeve të Asamblesë, ne kemi regjistruar projektin për funksionalizimin dhe blerjen e pajisjeve për “Eko-Theranda”. Në programin e PIP-it kemi listuar disa nga pajisjet që kishim planifikuar të blihen, por ato nuk janë marrë parasysh, për shkak se nuk janë specifikuar saktësisht me emër dhe përshkrim të detajuar. Kjo ndodhi për shkak se projekti u aprovua në Asamble në këtë formë. Si rezultat, ky projekt është vendosur në fondin rezervë, që do të thotë se nuk mund të shfrytëzohet në këtë formë. Për të mundësuar përdorimin e tij, duhet të plotësohen kriteret e përcaktuara nga udhëzimet administrative, të marrë kodin përkatës dhe të zhvendoset nga kodi 38 në kodin 30. Më pas, projekti do të marrë një kod unik pesëshifror dhe vetëm atëherë mund të implementohet. Në gjendjen aktuale, ky fond nuk mund të përdoret. Si rezultat, ky projekt është vendosur në fondin rezervë, që do të thotë se nuk mund të shfrytëzohet në këtë formë. Për të mundësuar përdorimin e tij, duhet të plotësohen kriteret e përcaktuara nga udhëzimet administrative, të marrë kodin përkatës dhe të zhvendoset nga kodi 38 në kodin 30. Më pas, projekti do të marrë një kod unik pesëshifror dhe vetëm atëherë mund të implementohet. Në gjendjen aktuale, ky fond nuk mund të përdoret.

Urim Suka - Në momentin kur Ministria e kalon një shumë në fondin rezervë, kjo nënkupton se ajo nuk mund të shfrytëzohet pa një rialokim të ri. Këto fonde nuk janë të destinuara për situata emergjente dhe nuk mund të përdoren për qëllime të tjera pa miratim të mëtejshëm.

Fadil Hoxha - Kjo nuk ka të bëjë me fondet rezervë për raste emergjente. Ky është një projekt kapital, por që nuk i ka plotësuar kriteret e kërkuara, prandaj është kaluar në fondin rezervë. Nëse dëshironi ta shfrytëzoni, është e nevojshme të plotësohen kriteret përkatës dhe projekti të trajtohet si i tillë.

Urim Suka - Mua më shqetëson gjithashtu fakti nëse dikush mund të japë një sqarim lidhur me blerjen e automjetit fshirës. A është e arsyeshme që kostoja e tij të jetë 200,000 euro? A është çmimi real apo i tepruar? A do të jetë ai funksional për nevojat tona? Në parim, unë mendoj se duhet të vazhdojmë me këtë proces, por më duhet një sqarim më i detajuar.

Liridon Fandaj - Gjatë themelimit të ndërmarrjes “Eko-Theranda”, shqetësimi kryesor ka qenë situata e punëtorëve të “Eko-Regionit”. A kemi krijuar një kompani minimale vetëm për ta mbyllur një kompani rajonale? Nuk jam i sigurt, por sipas të dhënave, Komuna jonë ka 13.1% të aksioneve. Për sa i përket auto-fshirësës, kompania ekzistuese tashmë po e kryen këtë punë me kapacitet të plotë. Ne, në vend që të mbështesim një kompani rajonale, po krijojmë një kompani konkurrente. Gjithashtu, nuk kemi asnjë raport zyrtar mbi këtë çështje – kush është drejtori, si funksionon bordi dhe çfarë detyrash ka. Nëse kemi

themeluar këtë ndërmarrje, duhet të dimë se sa punëtorë ka dhe kush do ta përdorë këtë auto-fshirëse. Nuk duhet të shpenzojmë 200,000 euro vetëm për të blerë një pajisje pa një plan të qartë operativ. Do të ishte më e arsyeshme të propozohej një projekt tjetër sesa të investojmë në një kompani për të cilën nuk kemi informacion të plotë. Do ta kisha mbështetur këtë projekt-vendim vetëm nëse do të kishim të gjitha të dhënat dhe një plan të detajuar mbi funksionimin e kompanisë. Për momentin, nuk kemi informacion të mjaftueshëm, prandaj nuk mund ta mbështes këtë projekt-vendim.

Kryesuesi- Nëse jeni të interesuar, unë kam kërkuar që të përgatitet një raport që nga momenti i themelimit të ndërmarrjes, e cila, nëse nuk gaboj, është themeluar në gusht dhe deri më 31 dhjetor. Aktualisht, ndodhemi në fazën e përgatitjes së llogarisë bankare të ndërmarrjes. Në fakt, llogaria është hapur, por fillimisht është regjistruar në emër të një personi tjetër, i cili tashmë është larguar. Për këtë arsye, duhet të bartet në emër të Kryeshefit Ekzekutiv. Dokumentacioni për këtë është dorëzuar në bankë dhe jemi në pritje të përgjigjes nga ana e tyre. Në muajin e ardhshëm, planifikoj të dorëzoj një raport mbi ecurinë e punës nga themelimi deri më 31 dhjetor. Ndërsa për vitin 2025 do të fillojë raporti tjetër, i cili do të përmbledhë pikat kryesore për Eko-Therandën. Sa i përket mjeteve financiare, siç e shpjegoi edhe z. Fadil, ato janë bartur në fondin rezervë. Aktualisht, nuk dihet se çfarë do të ndodhë me këto mjete, prandaj po kërkohet që ato të riallokohen për të filluar procedurat e nevojshme.

Avni Bytyqi- Kam qenë pjesë e hartimit dhe e studimit të kësaj ndërmarrjeje. Kjo ndërmarrje nuk është themeluar nga Kuvendi, por nga Qeveria. Me iniciativën e Kuvendit, nuk ka pasur qëllim që Eko-Theranda të mbyllë Eko-Regjionin si njësi rajonale, për shkak se, sipas çertifikatës së biznesit, Eko-Theranda nuk përfshin aktivitetet e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave. Eko-Regjioni ka kompetencat e veta për grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Suharekës. Ndërsa pjesa tjetër mbulohet nga Komuna përmes tenderëve dhe procedurave të tjera. Në kuadër të Eko-Therandës përfshihen aktivitete të tilla si pastrimi i rrugëve nëpër fshatra, krasitja e drunjëve përreth rrugëve, si dhe aktivitete të tjera me karakter pastrues. Sipas informacioneve të dhëna nga Kryetari, rreth 100,000 euro janë destinuar për blerjen e një autofshese, ndërsa pjesa tjetër e mjeteve është paraparë për pagesën e punëtorëve në rast se Eko-Theranda fillon funksionalizimin si ndërmarrje. Duhet pasur parasysh se Komuna ka një numër të caktuar punëtorësh dhe Qeveria nuk lejon shtimin e tyre. Eko-Theranda është në pronësi të Komunës 100%, pra Komuna e Suharekës është aksionare e vetme. Për këtë arsye, çdo shpenzim i Eko-Therandës duhet të raportohet te Kuvendi dhe Komuna. Sipas planit të punës, fondet e parapara duhet të barten te Kryeshefi Ekzekutiv, i cili më pas do t'i menaxhojë ato për pagesën e punëtorëve dhe për shpenzime të tjera të domosdoshme.

Kryesuesi – e hedh në votim pikën 4.

Me: 6votaPër, një Kundër, 0 Abstenim, miratohet

Pika 5. Shqyrtim i projekt-vendimit për miratimin e kërkesës;

Kryesuesi - e laboron këtë pikë dhe hap debatin.

Kryesuesi – pasi që nuk ka debat, e hedh në votim pikën 5.

Unanimisht Miratohet

Pika 6. Shqyrtimi i raportit vjetor për kontratat e nënshkruara publike për vitin 2024;

Kryesuesi - e laboron këtë pikë dhe hap debatin.

Liridon Fandaj- Unë e kam një pyetje, raportin e ka publiku Fatos Kuqi, cila është pozita për momentin e Fatos Kuqit në zyrën e prokurimit, a ka mandat për përpilim të raportit përfundimtar për vitin 2024 dhe për shqyrtim planifikimi për vitin 2025?

Kryesuesi- Është udhëheqës i Zyrës së Prokurimit.

Urim Suka- Në lidhje me raportin e kontratave, dua të theksoj dy kontrata specifike që paraqesin problematika të njëjta me kontrata të tjera dhe që mund të kërkojnë një sqarim më të detajuar në Asamble. Për këtë arsye, kërkoj sqarime në lidhje me dy çështje kryesore, nëse është e mundur që dikush të na ofrojë informacione më të qarta. Në mungesë të Drejtorit, ndoshta z. Fadil mund të na japë një informacion më të qartë mbi këto çështje. Së pari, në lidhje me ndërtimin e rrugëve lokale dhe vazhdimin

e rrugëve në lagjen Seferi, dy Martirët dhe Veteranët, në bazë të kontratës figuron se rruga Seferi dhe dy Martirët është përfunduar. Megjithatë, sipas informatave që kam, deri vonë kjo rrugë nuk ka qenë e përfunduar në terren, gjë që paraqet një shqetësim. Nëse në kontratë thuhet se është realizuar, ndërsa në realitet jo, atëherë është e nevojshme të qartësohet kjo situatë. Së dyti, në lidhje me ndërtimin e impiantit të ujërave të zeza në fshatin Sllapuzhan, nga dokumentacioni që kam përpara, rezulton se është lidhur një kontratë për këtë projekt, por në fund figuron se nuk është bërë pagesa për të. Kërkoj një sqarim nëse ky impiant është ndërtuar dhe, nëse jo, cilat kanë qenë arsyet e moszbatimit të kontratës dhe mosrealizimit të pagesës.

Kryesuesi – e hedh në votim pikën 6.

Me 3 Për, 1 Kunder, 2 Apstenime miratohet pika 6.

Pika 7. Shqyrtimi i planifikimit përfundimtar i prokurimit për vitin 2025;

Kryesuesi - e laboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka- Raporti i kontratave lidhet ngushtë me planifikimin e zyrës së prokurimit. Në këtë drejtim, kam disa shqetësime që dua t'i theksoj, të cilat lidhen me mospërputhje mes planifikimit të prokurimit dhe projekteve që realisht janë realizuar apo janë parashikuar për vitin e ardhshëm. Një nga shqetësimet kryesore është ndërtimi i rrugëve lokale në rrugët Bashkimi dhe Esat Qarri në Grejquevc. Sipas informacioneve që kam, muret lokale në rrugën Bashkimi janë ndërtuar gjatë vitit 2024. Megjithatë, ato figurojnë sërish në planifikimin e prokurimit për vitin e ardhshëm, që nënkupton se do të procedohet me tenderimin për një rrugë që tashmë është ndërtuar. Kjo ngre pikëpyetje mbi planifikimin dhe procedurat e ndjekura. Një tjetër çështje është ndërtimi i rrugëve lokale në lagjen Gashi", në Krushicën e Poshtme. Në bazë të planit të miratuar të buxhetit, është paraparë ndërtimi i rrugëve në rrugën "Liman Ademi". Mirëpo, në planin e prokurimit figuron ndërtimi i rrugëve në lagjen Gashi, gjë që përbën një mospërputhje të konsiderueshme. Mendoj se plani i prokurimit duhet të reflektojë saktësisht vendimin e Asamblesë dhe buxhetin e miratuar, pra nëse është miratuar ndërtimi i rrugëve në rrugën Liman Ademi për vitin 2025, atëherë edhe në planin e prokurimit duhet të figurojë ai, dhe jo ndërtimi i rrugëve në lagjen Gashi. Kjo devijim ose ndryshim i destinacionit të projektit ngre dyshime nëse është bërë me qëllim apo është thjesht një gabim teknik. Po ashtu, një shqetësim tjetër lidhet me ndërtimin e rrugëve lokale në rrugën Afrim Buqa. Kjo rrugë është planifikuar për ndërtim, mirëpo sipas informatave që kam, ndërtimi i saj tashmë është përfunduar, me përjashtim të ndonjë segmenti të vogël apo oborri. Megjithatë, ajo ende figuron në planin e prokurimit, gjë që kërkon sqarim. Besoj që në Asamble do të kemi një pasqyrë më të qartë për të gjitha këto çështje dhe për të siguruar që planifikimi i prokurimit të jetë në përputhje me buxhetin e miratuar dhe me punët e realizuara në teren.

Kryesuesi – e hedh në votim pikën 7.

Me 3 vota për, 0 Kundër, 2 Abstenim, miratohet pika 7.